

GJON BORIÇI**PËRPPJEKJET E QEVERISË SHQIPTARE PËR TË ARRITUR
INDUSTRIALIZIMIN E VENDIT ME ANË TË VEPRAVE
TË FUNDIT MADHORE NGA KINA NË SHQIPËRI
1966 - 1973****Abstrakt:**

Industrializimi si proces i ka kushtuar jashtëzakonisht shumë njerëzimit. Në epokën e Luftës së Ftohtë, Republika Popullore e Shqipërisë, veçanërisht në gjysmën e dytë të viteve '60 deri në gjysmën e parë të viteve '70 filloi një proces të ethshëm shpenzimesh marramendëse ekonomike për të arritur industrializimin e vendit edhe pse nuk kishte patur asnjë lloj eksperience në këtë fushë. Artikulli i mëposhtëm përpigjet të tregojë përpjekjet e ethshme të shtetit komunist shqiptar për të marrë sa më shumë kredi dhe ndihma nga Republika Popullore e Kinës në mënyrë që të arrihej brenda një kohe të shkurtër procesi i industrializimit të vendit. Artikulli është mbështetur në metodologjinë kërkimore-shkencore ku shumica e të dhënave i paraqiten për herë të parë publikut të interesuar për këtë temë. Gjithashtu, ndërthurja e dokumenteve arkivore me literaturën ndërkombëtare sjell një qasje origjinale krahasuese të subjektit shkencor të paraqitur në këtë artikull. Artikulli shpjegon arsyet se përse Shqipëria e kishte të pamundur të industrializohej në një kohë kaq të shkurtër, siç e kërkonte udhëheqja komuniste shqiptare dhe në fund jepen arsyet e dështimit industrial të Shqipërisë me gjithë kreditë dhe ndihmat kolosale të ardhura nga Republika Popullore e Kinës.

Fjalë kyçe:

Shqipëri, Kinë, kredi, industrializim, borxhe, ekonomi.

**Vijimi i kredive kineze në ndërtimin
e veprave madhore në Shqipëri**

Industrializimi si proces i ka kushtuar jashtëzakonisht shumë njerëzimit. Në kohën kur Republika Popullore e Shqipërisë (RPSH) po kërkonte në mënyrë utopike të industrializohej, Hemisfera Perëndimore

ishte në fillimin e fundit të Revolucionit të Dytë Industrial. Viti 1973, do të ishte viti i një krize ekonomike që askush se kishte parë.¹ Ky do të ishte edhe viti në të cilin kreditë dhe ndihmat kineze për të ndërtuar industrialisht Shqipërinë do të reduktoheshin në mënyrë thelbësore. Megjithatë, sidomos gjysma e dytë e viteve 60-të dhe më pak gjysma e parë e viteve 70-të do të ishin frytdhënëse për ekonominë e Shqipërisë, e cila nga kreditë e mëdha dhe eksperiencia kineze do të ndërtonte të pakën një nivel ekonomik që do ta lejonte vendin, për harkun kohor 1966-1970, të shkëputej nga limiti i mbijetesës në të cilin kishte jetuar deri në atë kohë. Si pasojë e kredive dhe ndihmave kineze nga vitet 1961-1970 dhe 1971-1975, që është edhe kredia e fundit akorduar Shqipërisë, vendi pati një zhvillim industrial domethënës për kushtet ekonomike. Prodhimi neto në industri (NMP-Net Material Product) sipas Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën, për Shqipërinë në vitet 1961-1970, ishte 7.4% dhe në vitet 1971-1975, 6.7%.² Më pas, prodhimi i materialeve neto industriale të vendit pas acarimit dhe mbi të gjitha pas prishjes me Republikën Popullore të Kinës (RPK), ra vazhdimisht³ e deri në faliment të plotë.⁴ Në këtë artikull do të ndalemi posaçërisht tek një hark kohor 7-vjeçar për të kuptuar sesa mundësi reale kishte Shqipëria të ndërtonte llojin e vet të industrializimit, për të vënë në jetë dëshirën e

¹ Jeremy Rifkin, *La troisième Révolution Industrielle; comment le pouvoir latéral va transformer l'énergie, l'économie et le monde*, përkthyer nga anglishtja prej Françoise et Paul Chemla, Arles: Babel, 2012, f. 21. Fjala është për krizën e naftës të vitit 1973, në të cilën vendet e OPEC (Organization of the Petroleum Exporting Countries) ndërprejnë eksportin e shitjes së naftës Shteteve të Bashkuara të Amerikës si përgjigje e ndihmës amerikane në armatime ndaj Izraelit gjatë luftës së Yom Kippur, festës hebraike, në të cilin vendi hebreu u përplas ushtarakisht me Egjiptin, Sirinë, Jordaninë dhe Irakun (me pjesëmarrjen e Algjerisë, Kubës, Marokut dhe Tunizisë) në me të koalicionit arab.

² Ian Jeffries, *Socialist economies and the transition to the Market; a guide*, London & New York: Routledge, 1993, f. 229. Llogaritja e NMP-së të Shqipërisë sipas këtij raporti të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara fillon në dhjetëvjeçarin 1961-1970 me 7.4% që janë edhe zeniti i marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe akordimi i kredive të mëdha nga ana e RPK-së.

³ *Po aty*. Të dhënat e Komisionit Ekonomik të OKB-së për Shqipërinë pas kredisë së fundit kineze akorduar më 1975, për NMP-në janë: 1976-1980 (2.7%); 1981-1985 (2.0%); 1986-1988 (1.7%); 1987 (0.7%); 1988 (0.3%); 1989 (2.4%).

⁴ *Po aty*, f. 365. GDP e Shqipërisë në vitin 1990 ishte -10% sipas Komisionit Ekonomik të OKB-së dhe në vitin 1991 prodhimi industrial neto dhe ai bujqësor ishin -60%.

Enver Hoxhës, që vendi të kthehej nga agraro-industrial në industrialo-agrar.

Gjysma e dytë e viteve 60-të në marrëdhëniet shqiptaro-kineze, do të karakterizohej nga akordimi i kredive edhe më të mëdha nga RPK ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Megjithëse për vitin 1965, Shqipëria mori 170 milion rubla kredi, përsëri kreditë dhe ndihmat nga Kina nuk reshtën.⁵ Më 5 mars 1966, Kryeministri shqiptar Mehmet Shehu i dërgoi një letër falënderimi homologut të tij kinez, Çu En Lai për dërgimin nga ana e Kinës, Shqipërisë 10 mijë ton farë patatesh falas.⁶ Kjo ndihmë u konsiderua nga kryeministri shqiptar si një tjetër provë e ndihmës bujare dhe kujdesit vëllazëror që RPK tregonte ndaj Shqipërisë.⁷

RPK në gjysmën e dytë të viteve 60-të ndodhej në fillimet e Revolucionit Kulturor. Gardistët e Kuq ishin kthyer në problemin më thelbësor të çdo ideje që nuk përshtatej me doktrinën revolucionare. Çdokush përfshirë edhe nga diplomatët e huaj ishte i rrezikuar në Pekin, përveç shqiptarëve.⁸ Për të treguar dashurinë ndaj Shqipërisë, më 28 nëntor 1968, ditën e Shpalljes së Pavarësisë së saj [Shqipërisë], një grup Gardistësh të Kuq i kishin dërguar një letër urimi Kryeministrit të

⁵ Shih Gjon Boriçi, "Veprat e para të mëdha të ndërtuara në Shqipëri me ndihmat dhe kreditë kineze 1963 - 1965", në *Studime historike*, nr. 3-4/2020, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2021.

⁶ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 490/Këshilli i Ministrave (më tej: KM), Viti (më tej: V.) 1966, Dosja (më tej: D.) 480, fl. 1. Letër e Mehmet Shehut për Çu En Lain mbi dërgimin falas të 10 ton farë patatesh nga Republika Popullore e Kinës.

⁷ *Po aty*, fl. 2. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait: "Ne me mirënjohje të thellë e ndjejmë sot përkrahjen dhe ndihmën tuaj bujare e vëllazërore edhe në fushatën që ka shpërthyer në vendin tonë për shtimin e prodhimit të patates si pjesë e luftës së madhe që bën populli ynë për të siguruar në të ardhmen bukën në vend, gjë që është një faktor i rëndësishëm për shpejtimin e ndërtimit të socializmit në Shqipëri dhe sigurimin e mbrojtjes së Atdeut".

⁸ Robert Bickers, *Out of China - How the Chinese ended the era of Western domination*, St Ives: Allen Lane, 2017, f. 345. "Në mbrëmjen e 22 gushtit 1967, pas disa javëve tensioni të qëndrueshëm..., 10 mijë veta nga Gardistët e Kuq mësynë ambasadën britanike. Njëzet e tre persona, staf i ambasadës u izoluan brenda kompleksit të saj dhe vunë në lëvizje planin 'Armageddon', ndërkohë që turma thërriste 'vriti, vriti'. Ata u nxorën forcërisht jashtë kompleksit, u goditën dhe u rrahën. Shumë prej tyre u detyruan të gjunjëzoheshin me duart pas koke dhe me kokën ulur për t'i fotografuar në shenjë poshtërimi. Shqiptarët nga ambasada e tyre që ndodhej në krahun tjetër të rrugës, shikonin nga dritaret me rroba gjumi dhe siç u raportua ishin në 'gaz'".

Republikës Popullore të Shqipërisë, Mehmet Shehut.⁹ Së bashku me letërën, Gardistët e Kuq i dërgonin edhe distinktivin e tyre me diçiturën:

"Ekspozita e Gardistëve të Kuq dhe e të revoltuarve revolucionarë të kryeqytetit".¹⁰

Nga ana e tij Kryeministri Shehu, i falënderoi për urimin dhe dhuratën Gardistët e Kuq të Pekinit me një letër të posaçme më 9 janar 1968.¹¹ Kryeministri shqiptar i uroi ata për punën e shkëlqyer në rrënimin e mbeturinave të botës së vjetër, që "goditën për vdekje borgjezinë, imperializmin, revizionizmin dhe agjenturën e tyre të maskuar në Kinë".¹²

Më 19 dhjetor 1968, ministri i Financave i RPSH-së, Aleks Verli, i paraqiti Byrosë Politike dhe qeverisë një informacion të detajuar për dëmin që i kishte shkaktuar Shqipërisë, prerja e ndihmave dhe kredive nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1961.¹³ Sipas ministrit Verli, shkelja e njëanshme e marrëveshjeve ekonomike, kulturore etj., dhe prishja e marrëdhënieve diplomatike nga ana e qeverisë sovjetike i kishte shkaktuar vendit një dëm të konsiderueshëm në ekonomi dhe në fusha të tjera.¹⁴ Në këtë raport flitet se deri në vitin 1956, marrëveshjet ishin zbatuar me korrektësi (1951-1955) e (1956-1960) dhe secila palë kishte zbatuar detyrimet përkatëse.¹⁵ Pas mbledhjes së Bukureshtit të qershorit 1960, qeveria sovjetike kishte ndërprerë furnizimin e Shqipërisë me një sasi të konsiderueshme gruri.¹⁶ Ministri Verli jep të detajuar në raportin e tij se Bashkimi Sovjetik kishte shkelur shtatë marrëveshje të ndryshme dhe shtatë protokolle në bazë të të cilave i ishin shkaktuar Shqipërisë dëme në mbrojtjen e vendit, në 17 objekte industriale dhe minerare, tre objekte të komunikacionit, dy objekte të arsim-kulturës si dhe dëme në fushën e bujqësisë, ndërtimit, shëndetësisë, tregtisë.¹⁷ Dëmi i shkaktuar

⁹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 650, fl. 5-6. Letër e Gardistëve të Kuq dërguar Mehmet Shehut.

¹⁰ *Po aty*, fl. 6.

¹¹ *Po aty*, fl. 7-9. Letër e Mehmet Shehut dërguar Gardistëve të Kuq.

¹² *Po aty*, fl. 7-8.

¹³ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 648, fl. 1-5. Përmbledhje e raportit mbi dëmet e shkaktuara nga shkelja e njëanshme e marrëveshjeve nga qeveria revizioniste e Bashkimit Sovjetik.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *Po aty*, fl. 2.

Shqipërisë nga prerja e ndihmave dhe kredive prej Bashkimit Sovjetik arrinte sipas ministrit shqiptar të Financave në 207 411 518 rubla.¹⁸ Ky dëm arrinte në 3 525 995 806 lek.¹⁹ Raporti që paraqiti ministri Verli ishte përgatitur vit pas viti duke filluar nga data 6 janar 1961.²⁰

Po në këtë vit, më 16 prill 1968, Kryeministri shqiptar Mehmet Shehu, i dërgoi një letër homologut të tij kinez lidhur me mundësinë e një kredie të re nga ana e RPK-së në mënyrë që Shqipëria të mund të ecte tërësisht me këmbët e veta.²¹ Qëllimi i kredisë së re që kërkonte qeveria shqiptare ishte të arrihej ndërtimi i industrisë përpunuese të lëndëve të para që gjendeshin në vend si mineral hekuri, kromi, bakri, ndërtimin e industrisë së përpunimit të thellë të naftës, zgjerimin e industrisë së prodhimit të plehrave kimike dhe zhvillimin e nevojshëm të industrisë elektrike.²² Në këtë vit, në Shqipëri me ndihmën dhe kredinë kineze të vitit 1965, kishte filluar të ndërtohej hidrocentrali i Vaut të Dejës, por Shqipëria kishte të tjera gjëra në mendje. Në letrën e tij, Mehmet Shehu, vuri në dukje se plani i katërt pesëvjeçar do të kishte disa ndryshime në objektet industriale të cilat do të fillonin të ndërtoheshin gjatë pesëvjeçarit të pestë, 1971-1975.²³ Këtë ndryshim planesh për ndërtimin e objekteve strategjike në industri dhe ekonomi, Kryeministri Shehu e justifikonte me përdorimin racional të burimeve të brendshme pasi

¹⁸ *Po aty*. Shifra e dëmeve ishte sipas tabelës së mëposhtme:

Ministritë	Humbjet e fitimit	Humbje të tjera	Humbje e tatimit mbi xhiro	Totali/Rubla
1/ Industria	3.416.978	2.113.242	7.838.581	13.368.801
2/Miniera	4.287.819	3.832.508	-	8.120.327
3/Bujqësia	1.348.584	38.792.182	-	40.140.766
4/Komunikacioni	-	768.317	-	768.317
5/Ndërtimi	44.774	62.098	-	106.872
6/Tregtia	-	2.890.000	-	2.890.000
7/ Shëndetësia	-	48.000	99.559	148.359
8/Arsim-Kulturë	-	5.835.426	-	5.835.426
9/Mbrojtja	-	136.032.650	-	136.032.650
Shuma:	9.098.155	190.375.323	7.938.140	207.411.518.

¹⁹ *Po aty*, fl. 5, 9. Kursi i këmbimit në atë kohë ishte 1 rubël=17 lekë.

²⁰ *Po aty*, fl. 50.

²¹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 649, fl. 1. Letërkëmbim ndërmjet qeverive të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për kredi afatgjatë, për furnizimin e RPSH-së me materiale luftarake.

²² *Po aty*, fl. 2.

²³ *Po aty*, fl. 3.

“Shqipëria ishte i vetmi vend socialist në zemër të Evropës kapitaliste dhe revizioniste dhe ecja e saj [Shqipërisë] me këmbët e veta kishte në radhë të parë rëndësi politike dhe ideologjike e më pas ekonomike”.²⁴

Objektet që kërkonte të ndërtonte Shqipëria me ndihmën e Kinës ishin të jashtëzakonshme për shpatullat e vendit. Si objekte të plota industriale, ajo kërkonte të ndërtoheshin me kredi nga Kina si më poshtë:

1. Uzina e metalurgjisë së hekur-nikelit me kapacitet shkrirjeje 800 mijë ton mineral-hekuri në vit dhe të ndërtohej në dy etapa ndërmjet viteve 1969-1972;

2. Hidrocentrali i Fierzës me fuqi 360 mijë-400 mijë kw së bashku me linjat T/N 220 kv dhe nënstacionet përkatëse, për t’u ndërtuar gjatë periudhës 1969-1976;

3. Uzina komplekse për përpunimin e thellë të naftës me impiantet përkatëse; të distilimit atmosferik me kapacitet 500 mijë ton naftë brut në vit, të koksifikimit të mazutit me kapacitet 700 mijë ton në vit; të krekingut katalitik me kapacitet përpunimi rreth 350 mijë ton distilate në vit; të hidro pastrimit të benzinës me kapacitet rreth 100 mijë ton benzinë dhe 200 mijë ton gazoil në vit; të platformingut të benzinës me kapacitet përpunimi rreth 100 mijë ton në vit; të pastrimit të gazrave nga sqfuri me kapacitet 140 mijë ton gazra në vit; TEC-i përkatës me fuqi të vendosur prej 15 mijë kw. Kjo uzinë duhej të ndërtohej gjatë periudhës 1970-1974;

4. Uzinë komplekse për petrokimi, me impiantet përkatëse; për prodhimin e polietilenit me kapacitet 10 mijë ton në vit;

5. Uzinë zgjerimi të prodhimit të plehrave azotike, për të shtuar kapacitetin edhe për 440 mijë ton nitrat amoni në vit në dy etapa përgjatë viteve 1960-1971 dhe 1973-1976;

6. Zgjerim i prodhimit të plehrave superfosfatike me shtim kapaciteti të uzinës në Laç edhe me 50 mijë ton superfosfat së bashku me repartin e hidrometalurgjisë së bakrit për t’u ndërtuar gjatë periudhës 1970-1971 dhe ndërtimin e një uzine të re të superfosfatit me kapacitet 150 mijë ton superfosfat në vit gjatë periudhës 1973-1976;

7. Ndërtim dhe mekanizim minierash fosforiti si dhe fabrikat përkatëse për pasurimin e mineralit me kapacitet projektuar prej 800 mijë ton mineral në vit;

²⁴ *Po aty.*

8. Zgjerimin e fabrikës së prodhimit të çimentos në dy fabrikat ekzistuese në Fushë-Krujë dhe Elbasan duke dyfishuar kapacitetin e tyre nga 100 mijë ton në 200 mijë ton secila;

9. Zgjerim i pasurimit të mineralit të bakrit të fabrikës në Repts²⁵ të Mirditës nga 60 mijë ton në 120 mijë ton në vit, si dhe ndërtimi i një fabrike tjetër pasurimi të bakrit me kapacitet 120 mijë ton mineral në vit;

10. Zgjerim i fabrikës për pasurimin e mineralit të kromit në Bulqizë nga 60 mijë ton në vit të parashikuar me marrëveshjen e 8 qershorit 1965, në 120 mijë deri 150 mijë ton mineral në vit;

11. Fabrikë për pasurimin e mineralit të azbestit me kapacitet prej 200 mijë ton mineral në vit, për t'u ndërtuar gjatë periudhës 1970-1972;

12. Zgjerimi i prodhimit të pjesëve të këmbimit për traktorë edhe për 4000 traktorë të tjerë me 15 kuaj fuqi në vit me dy ndresa brenda vitit 1970 etj.²⁶

Objektet që kërkonte Shqipëria për t'u ndërtuar me kredinë kineze ishin 21.²⁷ Industria e rëndë ishte ajo që do të gëzonte si gjithmonë përparësitë absolute të kërkesave të Shqipërisë. Insistimi i Byrosë Politike dhe qeverisë shqiptare për të marrë sa më shumë kredi dhe ndihma ishte i jashtëzakonshëm.

Ndërkohë, më datë 11 qershor 1968, zëvendëskryeministri Adil Çarçani priti në një takim anëtarët e delegacionit kinez të Ministrisë së Komunikacioneve.²⁸ Synimi i delegacionit kinez ishte të shikonte sesi kishte përparuar përmirësimi i portit të Durrësit dhe këtë ia konfirmuan edhe vetë Adil Çarçanit.²⁹ Në një tjetër takim që zëvendëskryeministri Çarçani pati me ambasadorin kinez (takimi nuk ka datë dhe numër protokolli), e vuri në dijeni për problemet që po paraqiste uzina e plehrave azotikë, e cila kishte hyrë në vitin e tretë të shfrytëzimit të saj.³⁰ Sipas Çarçanit, "një gjendje e tillë e kësaj uzine dhe deficitet që na ka krijuar, kanë patur dhe kanë pasoja të rënda për ekonominë tonë,

²⁵ *Po aty*, fl. 6-8.

²⁶ *Po aty*, fl. 10.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 651, fl. 1. Bisedë e zhvilluar ndërmjet Adil Çarçanit dhe delegacionit të Ministrisë së Komunikacioneve të Republikës Popullore të Kinës.

²⁹ *Po aty*, fl. 4. Ish drejtori i shoqërisë së lundrimit shqiptaro-kineze me qendër në Durrës, Tun Fua Min u shpreh: "...në krahasim me atë që e kam lënë unë, Durrësi ka bërë ndryshime të mëdha dhe të dukshme, sidomos përsa i përket ndërtimeve".

³⁰ *Po aty*, fl. 17. Për takimin me ambasadorin kinez lidhur me çështjen e Uzinës së Plehrave Azotike në Fier.

kryesisht për bujqësinë".³¹ Në fund të takimit Adil Çarçani i bëri me dije ambasadorit kinez se uzina edhe për vitin 1968 do të prodhonte 95 mijë ton dhe nëse do të vazhdonte kështu do të shkaktonte deficite të mëdha.³² Problemi qëndronte se pajisjet për këtë uzinë do të bliheshin nga pala kineze në Itali tek firma "Montekatini", por kjo e fundit ngulmonte se Kina i detyrohej edhe 800 mijë dollarë amerikanë për pajisjet e plota që ende s'i kishte dërguar.³³ Për këtë çështje, Adil Çarçani mendonte ta demaskonin publikisht "Montekatini"-n nëpërmjet Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH).³⁴ Lidhur me këtë bisedë nuk pati asnjë lloj reagimi nga ambasadori kinez.

Ndërkaq, më datë 3 korrik 1968, përsëri Kryeministri Mehmet Shehu i dërgoi një letër të re Çu En Lait ku e vë në dijeni se mësimet e Revolucionit Kulturor kinez po aplikoheshin edhe në Shqipëri.³⁵ Në këtë kohë, sipas Mehmet Shehut ishte në proces aplikimi në praktikë i fjalimit të Enver Hoxhës "Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë", mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike, më 7 mars 1968.³⁶ Me anë të kësaj letre, Kryeministri Shehu dëshironte t'i bënte të ditur homologut të tij kinez se Shqipëria do të aplikonte po të ishte nevoja edhe mënyrën kineze të jetesës vetëm e vetëm që vendi i madh aziatik të vijonte të dërgonte ndihma dhe kredi. Në letrën e 3 korrikut, Mehmet Shehu insistonte që të shkonte në Pekin një delegacion i lartë qeveritar shqiptar për të negociuar kredinë e re.³⁷ Synimi ishte që të mund të arrihej një marrëveshje me Kinën për kredi për ndërtimin e veprave të plota që ishin parashtruar në letrën e 16 prillit 1968.

Një tjetër problem që kishte Shqipëria ishte edhe mungesa e valutës së lirë në masën më minimale të domosdoshme për të mundur të manovronte në tregun ndërkombëtar për të përballuar kërkesat më të ngutshme për ekonominë e vendit.³⁸ Synimi i vërtetë i kërkesës që bënte Mehmet Shehu ishte që Kina ta furnizonte me armë Shqipërinë duke

³¹ *Po aty*.

³² *Po aty*, fl. 22.

³³ *Po aty*, fl. 20.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 649, fl. 13. Letër e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ *Po aty*, fl. 14. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "Propozojmë që delegacioni i kryesuar nga Adil Çarçani të arrijë në Pekin nga mesi i muajit tetor të këtij viti".

³⁸ *Po aty*, fl. 15.

paraqitur si justifikim se Jugosllavia dhe Greqia për të dalë nga vështirësitë e tyre të brendshme, sipas kryeministrit shqiptar, mund të ndërmerren veprime luftarake kundër vendit.³⁹ Lidhur me këtë, Shehu i kërkonte Çu En Lait që RPK të shikonte mundësinë e mosshtryjes së afatit të dërgimit të armatimeve brenda vitit 1968 dhe nëse nuk realizohej kjo ato të lëvroheshin brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1969.⁴⁰ Armatimi kërkohej për të përforcuar akoma më shumë mbrojtjen e vendit pasi Shqipëria “nuk kishte asnjë garanci për politikën aventureske, siç shprehej Shehu, të Greqisë dhe të Jugosllavisë dhe se ende nuk kishte shpresë që të hapet kanali i Suezit”.⁴¹

Kryeministri kinez iu përgjigj letrës së homologut të tij shqiptar, më 15 gusht 1968.⁴² Çu En Lai ishte dakord që delegacioni i lartë qeveritar shqiptar të vinte në Pekin në gjysmën e parë të muajit tetor 1968.⁴³ Për pikën më të nxehtë të kërkesave, atyre ushtarake, kryeministri kinez shprehej se qeveria kineze do të bënte ç'ishte e mundur që mjetet ushtarake për Shqipërinë megjithë vështirësitë të lëvroheshin brenda vitit 1969.⁴⁴ Në fund të letrës, Çu En Lai për të siguruar edhe një herë Shqipërinë për miqësinë dhe ndihmën e pandryshueshme të Kinës, e mbyll me një citat të Mao Ce Dunit:

"Pavarësisht nga çfarëdo që të ndodhë në botë, dy partitë dhe dy popujt tanë me siguri do të qëndrojnë së bashku, do të luftojnë së bashku dhe do të fitojnë së bashku".⁴⁵

Kryeministri shqiptar iu përgjigj letrës së Çu En Lait, më 6 shtator 1968.⁴⁶ Në letër, Shehu shprehte kënaqësinë e fitoreve të përditshme të Revolucionit Kulturor kinez të udhëhequr nga marksist-leninisti i madh, Mao Ce Dun.⁴⁷ Përveç gëzimit për fitoret e Revolucionit Kulturor, kryeministri shqiptar e njoftoi Çu En Lain se delegacioni qeveritar shqiptar do të vinte në Pekin në gjysmën e tetorit 1968.⁴⁸

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ *Po aty*, fl. 16.

⁴² *Po aty*, fl. 20-22.

⁴³ *Po aty*, fl. 21.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *Po aty*.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 23.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 24. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "Delegacioni ynë ekonomik, që do të kryesohet nga anëtari i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave

Pika nevralgjike e kërkesave të qeverisë shqiptare mbetej ajo e armatimit luftarak. Në fund të letrës, Mehmet Shehu shpreh bindjen se Republika Popullore e Kinës mbështetur në mundësitë e saj reale dhe në nevojat që kishte Shqipëria nuk do t'ia kursente ndihmën në këtë fushë.⁴⁹

Kredia e madhe e 20 nëntorit 1968 si dhe ndihmat e mëdha ushtarake që u premtuan të lëvroheshin nga Kina e ngazëllyen udhëheqjen shqiptare. Përpara se t'i dërgonte Çu En Lait një letër falënderimi, Kryeministri Mehmet Shehu, kërkon aprovimin e Enver Hoxhës me anë të një letre më 9 dhjetor 1968.⁵⁰ Pas konfirmimit, në letrën e falënderimit që Mehmet Shehu i dërgonte Çu En Lait, më 11 dhjetor 1968,⁵¹ shprehet i gjithë gëzimi i udhëheqjes më të lartë politike të vendit. Pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, kredia e re ekonomike dhe furnizimet e panumërta me armatime të lehta e të rënda ishte për qeverinë shqiptare një varkë e re shpëtimi. Më shumë udhëheqja shqiptare ishte gëzuar për furnizimet ushtarake sesa për ndihmat dhe kredinë ekonomike. Ky fakt pasqyrohet në këtë letër ku Mehmet Shehu i kushton pjesën më të madhe të falënderimit homologut të tij kinez për furnizimet ushtarake.⁵²

shoku Adil Çarçani, do të përbëhet nga këta persona: kandidati i Byrosë Politike dhe ministër i Industrisë dhe i Minierave shoku Koço Theodhosi, zëvendëskryetari i Komisionit të Planit të Shtetit shoku Pupo Shyti, zëvendësministri i Tregtisë shoku Vasil Kati, zëvendësministri i Ndërtimit shoku Rahman Hanku, zëvendësministri i Bujqësisë shoku Sali Kubati, ambasadori ynë në Pekin shoku Vasil Nathanaili, dhe atasheu ynë tregtar në Pekin shoku Gogo Kozmai. Bashkë me delegacionin do të jetë një grup specialistësh dhe teknikësh prej rreth 16 vetash, të cilët, sipas kërkesës së palës tuaj do të mbërrijnë në Pekin disa javë më përpara delegacionit, në mënyrë që të bashkëpunojnë me shokët e aparateve tuaja për përgatitjen e materialeve të nevojshme për çështjet që do të shqyrtohen në bashkëbisedimet e delegacionit tonë me Palën tuaj". Shih edhe Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: MIRGEERALB, 2016, f. 161-162; *Shqipëria dhe Kina - Marrëdhënie e ngushtë në sfondin e Luftës së Ftohtë. Dokumente 1956-1978*, përgatiti për botim Gjon Boriçi, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 250-292.

⁴⁹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 649, fl. 25.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 31. Letra e Mehmet Shehut dërguar Enver Hoxhës: "Shoku Enver, mejtoj se është oportune t'i dërgoj një letër falënderimi Çu En Lait për ndihmën ekonomike dhe ushtarake. Tekstin e letrës po jua dërgoj për ta parë. Paragrafi i shënuar anash me të kuqe (në faqen 2) mund edhe të mos vihej".

⁵¹ *Po aty*, fl. 27.

⁵² *Po aty*, fl. 28. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "...me rastin e vizitës që bëri në vendin tonë këto ditët e fundit delegacioni i partisë, qeverisë dhe ushtrisë kineze i kryesuar nga anëtari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze, shoku Huan Jun

Aprovimi i kësaj kredie kishte qenë një nga negociatat më të lodhshme për delegacionin shqiptar. Ekspertët shqiptarë, sipas raportit që i paraqiti Adil Çarçani Komitetit Qendror, kishin shkuar që më datë 17 shtator 1968 në Pekin, një muaj para delegacionit qeveritar për të përgatitur terrenin.⁵³

Po më datë 11 dhjetor 1968, zëvendëskryeministri Çarçani priti në një takim falënderimi ambasadorin kinez Li Tin Ciuan.⁵⁴ Zëvendëskryeministri shqiptar i shprehu falënderimet më të përzemërta ambasadorit kinez për marrëveshjet e përfunduara me Republikën Popullore të Kinës dhe e siguroi për miqësinë e pandryshueshme të qeverisë dhe popullit shqiptar për popullin kinez.⁵⁵ Duke përfituar nga ky rast, Adil Çarçani i dorëzoi letrën e falënderimit që Mehmet Shehu i dërgonte kryeministrit kinez, Çu En Lai.⁵⁶ Sipas zëvendëskryeministrit shqiptar, "ishte fat i madh për popujt e botës që edhe pse së shpejti kryetari Mao do të mbushte 75 vjeç, zotëronte shëndet të plotë".⁵⁷ Nga ana e tij, ambasadori kinez falënderoi bashkëbiseduesin e tij mbi të gjitha se hidrocentrali i Vaut të Dejës që po ndërtohej me ndihmën e RPK-së do të mbante emrin "Mao Ce Dun".⁵⁸

Pamundësia e RPSH për të përballuar shpenzimet e veprave industriale

Më 19 shtator 1969, zëvendëskryeministri Adil Çarçani zhvilloi një bisedë me ambasadorin e ri të Republikës Popullore të Kinës, Gën

Shen, u konkretizua edhe zgjidhja për plotësimin e kërkesave tona suplementare mbi armatimin dhe pajisjen e mëtejshme të Ushtrisë Popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë nga ana e Republikës Popullore të Kinës. Kjo ndihmë e re ushtarake nga ana e Republikës Popullore të Kinës do ta forcojë akoma më shumë fuqinë mbrojtëse të vendit tonë socialist".

⁵³ *Po aty*, fl. 63. Raport mbi punën e delegacionit ekonomik qeveritar në Republikën Popullore të Kinës. Në bazë të vendimit të Byrosë Politike, delegacioni qeveritar ekonomik, prej datës 17 shtator deri më datën 19 nëntor, trajtoi me palën kineze, kërkesën për ndërtimin në RP të Shqipërisë të një numri objektesh nga ana e RP të Kinës, sipas letrës drejtuar shokut Çu En Lai nga ana e shokut Mehmet Shehu.

⁵⁴ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1968, D. 651, fl. 23. Protokoll mbi bisedën e zhvilluar midis zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave shokut Adil Çarçani dhe të Ngarkuarit me Punë a.i. R.P. të Kinës në R.P. të Shqipërisë shokut Li Tin Ciuan.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 24.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *Po aty*, fl. 26.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 27.

Biao.⁵⁹ Qëllimi i vizitës ishte të jepej një informacion sesi po ecnin punimet në hidrocentralin e Vaut të Dejës që ishte quajtur "Mao Ce Dun".⁶⁰ Deri në atë moment, ky hidrocentral ishte edhe vepra më madhore që po ndërtohej në Shqipëri. Përveç këtij hidrocentrali, me ndihmën e Kinës, Shqipëria po ndërtonte vepra të tjera madhore akoma më të mëdha si hidrocentrali i Fierzës, Kombinati Metalurgjik në Elbasan, uzina e përpunimit të thellë të naftës në Ballsh.⁶¹ Për të gjitha këto vepra, zëvendëskryeministri Çarçani nuk hezitoi ta falënderonte ambasadorin Biao. Nga ana e tij, ambasadori kinez kur mori fjalën, shprehu habinë kur kishte parë punëtorët që punonin për ndërtimin e hidrocentralit të Vaut të Dejës.⁶² Ai i kishte parë ata të punonin pa veshje mbrojtëse, si kapela, xhaketa etj.⁶³ Punëtorët shqiptarë punonin në kushte të një mjerimi të vërtetë, por këtë ambasadori kinez nuk e përmendi, por u mjaftua të thoshte se ata nuk trembeshin nga vështirësitë dhe se punonin për veten e tyre.⁶⁴

Nga ana e tij, Adil Çarçani u shpreh se direktiva e Partisë së Punës ishte që të ndërtohej socializmi me forcat tona.⁶⁵ Duke parë se bashkëbiseduesi i tij qëndroi i heshtur, Çarçani shtoi se pa ndihmën e Kinës ishin disa gjëra që nuk përballoheshin dot nga Shqipëria.⁶⁶ Për këtë arsye, ai e kishte kërkuar këtë takim pasi miq e vëllezër tjetër përveç kinezëve, Shqipëria nuk kishte.⁶⁷ Arsyeja e vërtetë se përse Adil Çarçani kishte thirrur në takim ambasadorin kinez, kishte të bënte me industrinë e naftës pasi atij i ishte ngarkuar kjo detyrë nga partia.⁶⁸ Sipas informacioneve që kishte marrë, në afërsi të bregdetit të Durrësit në largësi 200 metra nga toka thellë në det kishte gaz dhe kishte 10 vjet që

⁵⁹ AQSH, F. 490/KM, V. 1969, D. 582, fl. 1. Bisedim i zhvilluar në takimin që bëri me kërkesën e tij, zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, shoku Adil Çarçani me ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të R.P. të Kinës, shokun Gën Biao, më datë 19.9.1969.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 2.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² *Po aty*, fl. 3.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*.

⁶⁵ *Po aty*.

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ *Po aty*.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 4-5.

dilte gaz.⁶⁹ Në bregdetin e Italisë ishte zbuluar një vend burim gazi dhe atje vazhdohej të punohej, “por ajo zonë kishte rënë në dorë të imperialistëve amerikanë e holandezë kështu që Shqipëria nuk mund t’u drejtohej atyre”.⁷⁰

Ambasadori kinez nuk u tund nga ky informacion, por ia priti shkurt Adil Çarçanit:

"Është shumë e drejtë, këto duhet t'i bëni vetë".⁷¹

Adil Çarçani bëri sikur nuk e kuptoi këtë frazë të ambasadorit, por i tha se qeveria shqiptare ishte gëzuar shumë për sukseset e Kinës në shpimet e puseve në Detin e Verdhë 50 km nga porti Singan i qytetit të Tiencinit.⁷² Duke patur parasysh këtë sukses, qeveria shqiptare ia kishte parashtruar këtë çështje Çu En Lait dhe Li Hsien Nienit, por ata i kishin thënë se ende Kina nuk e kishte zgjidhur këtë çështje.⁷³ Megjithatë, Adil Çarçani këmbëngulte dhe i kërkoi ambasadorit kinez që në bazë të marrëveshjeve të vitit 1968, parashikohej të vinte në Shqipëri një ekspeditë kineze për çështje të naftës dhe gazit dhe të vizitonte bregun në Bishtin e Pallës ku ishin dhënë shenja gazi.⁷⁴ Shqipëria nuk kishte të ngopur nga ndihmat dhe kreditë kineze dhe përsëri e përsëri kërkonte nga Kina gjithçka. Sipas Çarçanit, ndihma e sinqertë dhe vëllazërore e Republikës Popullore të Kinës nuk i kishte munguar asnjëherë Shqipërisë dhe shprehte besimin se edhe kjo çështje do të zgjidhej me sukses.⁷⁵ Si për t'i dhënë sadopak shpresë interlokutorit të tij, ambasadori Biao u shpreh:

"Kërkesën tuaj, do t'ia transmetoj menjëherë qeverisë time, sigurisht brenda mundësive tona në këtë do ta marrim parasysh dhe do ta plotësojmë, ashtu siç i kemi plotësuar gjithnjë, përveç rasteve që kanë qenë jashtëzakonisht të vështira dhe që nuk kemi mundur t'i zgjidhim. Por, këtu është çështja e kohës, afati kur kërkohet nëse jemi në gjendje ta respektojmë".⁷⁶

⁶⁹ *Po aty*, fl. 5.

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Po aty*, fl. 6.

⁷³ *Po aty*.

⁷⁴ *Po aty*.

⁷⁵ *Po aty*.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 7. Pjesë nga fjala e ambasadorit kinez në takimin me Adil Çarçanit: "Është shumë e drejtë, gazi dhe nafta janë shumë të rëndësishëm për ekonominë. Shpesh ku

Shqipëria kishte një prapambetje të madhe në fushën e nxjerrjes së naftës. Ambasadori Biao shprehu gatishmërinë që të priste një grup naftëtarësh shqiptarë në Kinë për të mësuar nga eksperiencia e Taçinit.⁷⁷ Gjithashtu, ambasadori Biao i premtoi zëvendëskryeministrit shqiptar se Kina do t'i mësonte Shqipërisë një metodë për shpim të puseve të naftës me aftësi 2500 metra thellësi për 20 ditë, metodë që as sovjetikët e as rumunët nuk e kishin, sipas ambasadorit.⁷⁸ Në përfundim të takimit, Adil Çarçani i dorëzoi ambasadorit Gën Biao promemorien lidhur me kërkesën e qeverisë shqiptare drejtuar qeverisë kineze për shpimet sizmike në det.⁷⁹ Me kaq, takimi u mbyll.

Më 4 tetor 1969, zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH-së Spiro Koleka, i dërgoi Komisionit të Planit të Shtetit, Ministrisë së Industrisë dhe Minierave dhe Ministrisë së Ndërtimit një studim mbi nevojat në oksigjen dhe karbit për veprat që do të ndërtoheshin me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës gjatë pesëvjeçarit të pestë 1969-1976.⁸⁰ Sipas zëvendëskryeministrit Koleka, studimi në fjalë kishte si synim marrjen e masave në kohë për të siguruar oksigjenin dhe karbitin e nevojshëm që do të përdorej për ndërtimin e veprave në bazë të marrëveshjes së 20 nëntorit 1968.⁸¹

Për çdo vepër që do të ndërtohej, sasia e oksigjenit që synohej të prodhohej arrinte në miliona litra në vit.⁸² Nga studimi i detajuar që kishte paraqitur Spiro Koleka, për vitet më të ngarkuar me montimin e veprave (1973-1974) do të nevojiteshin rreth 2 milion litra oksigjen në vit që së bashku me rreth 6 milion litra në vit të planifikuar nga ana e dikastereve arrinin në 8 milion litra në vit oksigjen dhe 1600 ton karbit në vit.⁸³ Sipas Kolekës, specialistët kinezë që kishin ardhur në Shqipëri, kishin saktësuar se vlera monetare për të arritur një shkallë të tillë prodhimi sidomos në metalurgjikun e Elbasanit, në hidrocentralin e

ka naftë ka edhe gaz. Unë kam vizituar disa burime tuaja të naftës dhe kam vënë re se metoda e nxjerrjes së naftës është shumë e prapambetur dhe kushton shumë".

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 7.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 8.

⁸⁰ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1969, D. 588, fl. 1. Studim i aparatit të Këshillit të Ministrave për nevojat në oksigjen dhe karbit që do të ndërtohen me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës.

⁸¹ *Po aty*, fl. 2.

⁸² *Po aty*.

⁸³ *Po aty*, fl. 3.

Fierzës dhe në azotikun e Fierit, i tejkalohte disa herë nevojat financiare për të bërë të mundur ndërtimin e tyre.⁸⁴ Si përfundim, Spiro Koleka argumentonte se lidhur me sigurimin e impianteve të oksigjenit dhe të fabrikës për prodhimin e karbitit të rishikoheshin llogaritjet në mënyrë që t'i dilej përpara punës së përfundimit të veprave gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm.⁸⁵ Nevojat për karbit ishin nxjerrë nga sasia e nevojshme në oksigjen bashkë me veprat që ishin ndërtuar duke nxjerrë si normativë mesatare harxhimin e karbitit në uzinat e vendit për saldime dhe prerje. Sipas përlllogaritjeve për një kilogram karbit, harxhoheshin mesatarisht 5 litra oksigjen.⁸⁶ Veprat e ndërtuara me ndihmën e Kinës dhe kishin prodhimin më të madh të karbitit ishin: NISH Kimike në Tiranë me prodhim 700 ton karbit në vit, dhe Kombinati i Sheqerit në Maliq me 100 ton.⁸⁷ Zgjerimi i këtyre veprave dhe të tjerave do t'i kushtonte buxhetit të Shqipërisë miliona lekë shpenzime të panevojshme. Po ç'rëndësi kishte. Mjaftonte që Shqipëria të kishte industrinë e saj të rëndë efektive edhe me kosto të papërbalueshme për shqiptarët. Nga ky raport, dukej qartë se Shqipërisë i duheshin para të tjera nga Kina.

Pagesa nga Kina për "hatër" të Shqipërisë

Më 16 janar 1970, zëvendëskryeministri i parë i RPSH-së Adil Çarçani pati një takim me ambasadorin e RPK-së në Tiranë, Gën Biao lidhur me disa probleme që kishte paraqitur uzina e plehrave azotikë në Fier.⁸⁸ Kjo uzinë sipas Çarçanit, e kishte kapacitetin të përcaktuar në 110 mijë ton prodhim dhe planin, ajo e kishte plotësuar me vështirësi, 85%.⁸⁹ Fajtor për këtë gjendje, zëvendëskryeministri shqiptar bëri firmën italiane "Montekatini" ku Kina kishte blerë makineritë për uzinën.⁹⁰ Sipas Adil Çarçanit, firma italiane kërkonte edhe 800 000 \$ për të sjellë në Shqipëri pajisjet e plota për uzinën.⁹¹ Zëvendëskryeministri shqiptar iu shpreh

⁸⁴ *Po aty*.

⁸⁵ *Po aty*, fl. 4.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 8.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1970, D. 501, fl. 1. Bisedim i zhvilluar midis zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave shokut Adil Çarçani dhe ambasadorit të RP të Kinës në RP të Shqipërisë shokut Gën Biao.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*, fl. 2.

⁹¹ *Po aty*, fl. 3.

ambasadorit kinez se qeveria shqiptare mendonte ta hidhte në gjyq firmën italiane.⁹² Por, ambasadori kinez u shpreh se shqiptarët duhej të tregoheshin të kujdesshëm pasi Kina me Italinë kishin marrëdhënie tregtare.⁹³ Për hatër të Shqipërisë, kinezët kishin blerë pajisjet e kësaj uzine me vlerë 14 milion \$.⁹⁴ Adil Çarçani shprehu habi për një shifër të tillë dhe iu shpreh ambasadorit se këtë gjë nuk e dinte.⁹⁵ Nga ana e tij ambasadori Biao, me shumë takt iu përgjigj interlokutorit të tij shqiptar se Kina e kishte blerë uzinën për të ndihmuar miken e saj të ngushtë Shqipërinë, dhe për përsa i përket hedhjes në gjyq ajo ishte punë e sovranitetit të Shqipërisë.⁹⁶

Duke kuptuar mesazhin e qartë të ambasadorit, Adil Çarçani ndryshoi menjëherë bisedë. Zëvendëskryeministri shqiptar informoi ambasadorin Biao se gjatë punës për të shpuar një pus të ri naftë kishte patur burim gazi dhe pusi kishte marrë flakë.⁹⁷ Flakët ishin vënë nën kontroll, por pusi kishte dalë jashtë përdorimi. Kështu, Adil Çarçani i kërkoi ambasadorit Biao dërgimin e disa specialistëve kinezë për të përshpejtuar mbylljen e këtij pusi.⁹⁸ Nga ana e tij, ambasadori Biao e pranoi menjëherë këtë kërkesë.⁹⁹

Në fund të bisedës, zëvendëskryeministri shqiptar trajtoi problemet që kishte hasur Shqipëria për këtë vepër dhe për problematikën që kishin shfaqur materialet e blera, nuk ishte faji i punonjësve shqiptarë, por i firmës italiane.¹⁰⁰ Firma "Montekatini" ishte asokohe një nga firmat më të dëgjuara në botë për prodhim pajisjesh dhe nuk kishte patur probleme tregtare në asnjë vend të Evropës dhe botës ku dërgonte materialet e veta.

⁹² *Po aty*.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *Po aty*, fl 4.

⁹⁵ *Po aty*. Pjesë nga biseda. Adil Çarçani: "...jua kanë shitur shumë shtrenjtë nga 7 milion\$ në 14 milion\$, për këtë nuk kam dijeni, është hera e parë që e dëgjoj".

⁹⁶ *Po aty*, fl. 7. Pjesë nga fjala e ambasadorit Gën Biao: "Ju mund të veproni sipas mendimit tuaj. Në qoftë se ne e blemë uzinën më shtrenjtë këtë ne e bëmë për miqtë tanë të ngushtë. Ju veproni duke patur parasysh punën tuaj, kjo është e drejta e sovranitetit tuaj. Për marrëdhëniet tona me italianët mos u shqetësoni, ata nuk kanë çfarë të na bëjnë".

⁹⁷ *Po aty*.

⁹⁸ *Po aty*.

⁹⁹ *Po aty*. Pjesë nga fjala e ambasadorit Biao: "Për këtë kërkesë unë e ndjej të nevojshme t'i raportoj qeverisë menjëherë. Pavarësisht se deri ku arrijnë mundësitë tona teknike, kjo kërkesë tregon një mirëbesim që keni tek neve".

¹⁰⁰ *Po aty*, fl. 8.

Problemi mund të qëndronte tek aftësia e specialistëve shqiptarë dhe kinezë, por asnjë nga këto gjëra nuk provohen në dokumentin në fjalë. Adil Çarçani mjaftohet duke thënë se "kapitalistët janë të poshtër dhe të pabesë dhe që na kanë pajisur me makineri të dobëta dhe që prisheshin shpejt".¹⁰¹

Shqipëria kishte nevojë që të specializonte njerëzit e saj që do të punonin në veprat që do të ndërtoheshin nga Kina. Për këtë arsye, më 28 prill 1970, për nevoja të punës në hidrocentralin e Vaut të Dejës, do të dërgohej për një periudhë 35 ditore specializimi, Emin Mysliu.¹⁰² Të gjitha shpenzimet e këtij specializimi do të mbuloreshin nga qeveria shqiptare.¹⁰³ Deri në fund të vitit 1970, numri i personave që do të shkonin për specializim në Kinë nga Republika Popullore e Shqipërisë vetëm nga Ministria e Ndërtimit do të arrinte 11 veta.¹⁰⁴ Shpenzimet për këta specialistë sipas urdhrit të zëvendëskryeministrit Çarçani do të ishin jo të vogla për buxhetin e qeverisë.¹⁰⁵

Shqipëria për të përmbushur nevojat e saj në fushën e bujqësisë dhe të blegtorisë kishte nga Kina një fond/kredi të veçantë në valutë të lirë. Deri më 20 maj 1970, nga ky fond ishin shpenzuar 11 493 300 \$.¹⁰⁶ Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë të datës 17 qershor 1970, ishte vendosur që herë pas here të përdroreshin pjesë valute të huaj nga ky fond për të blerë pajisje mekanike, e makineri të ndryshme me vlerë 6 309 200 \$ prej të cilave 3 862 200 \$ për vitin 1969 dhe 2 447 000 \$ për vitin 1970.¹⁰⁷ Për blerjen e kafshëve të racës (viça, mushqerra, dema, derra e dosa) gjithsej 10 694 krerë, më vlerë të përgjithshme 4 049 100 \$ prej të cilëve 4 244 krerë me vlerë 1 484 100 \$

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² *AQSH*, F. 490/KM, V. 1970, D. 502, fl. 1. Në lidhje me dërgimin në Republikën Popullore të Kinës të Emin Mysliut.

¹⁰³ *Po aty*.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 6. Mbi dërgimin e grupit për thjeshtimin e projekteve në Republikën Popullore të Kinës.

¹⁰⁵ *Po aty*, fl. 7. "Për grupin e specialistëve që do të shkojnë për 2 muaj në RP të Kinës për shqyrtimin, thjeshtimin dhe aprovimin e projekteve të veprave industriale, Ministrisë së Ndërtimit i nevojiten 62.000 lekë valutë, duke qenë se ajo disponon vetëm 32.000 lekë, diferencën prej 32.000 lekësh valutë të përballohet nga fondi rezervë i Qeverisë", Adil Çarçani, 25.XII.1970.

¹⁰⁶ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1970, D. 495, fl. 1. Njoftim mbi zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave që trajtojnë përdorimin e valutës së lirë nga fondi i kredisë së veçantë të R.P. të Kinës.

¹⁰⁷ *Po aty*.

gjatë vitit 1969 dhe 6 450 krerë me vlerë 2 565 000 \$ gjatë vitit 1970;¹⁰⁸ fidanë pemësh frutore, farë misri hibrid dhe farërave të ndryshme perimesh me vlerë prej 1 135 000 \$ nga e cila 500 000 \$ gjatë vitit 1969 dhe 635 000 \$ gjatë vitit 1970.¹⁰⁹ Deri më 20 qershor parashikohej që të shpenzoheshin edhe 172 160 \$ për katër linja tip Sinoleia dhe 10 copë presa për prodhimin e vajit të ullirit.¹¹⁰ Për zgjerimin e kripores së Skrofotinës do të shpenzohej një fond prej 400 000 \$.¹¹¹ Për prodhimin e karamelave të buta do të shpenzoheshin 25 000 \$;¹¹² Për fabrikën vaj luledielli, 97 000 \$¹¹³; pajisje plotësuese për fabrikën e djathit do të lëvroheshin 34 000 \$ etj.¹¹⁴ Gjithsej, për 29 pajisje që kërkoheshin të bliheshin në Evropën Perëndimore, Shqipëria nga fondi i veçantë i valutës së lirë, do të shpenzonte 20 587 500 \$.¹¹⁵ Se sa ishte i plotë ky fond i akorduar nga Republika Popullore e Kinës, nuk kam arritur ta gjej në dokumentet që kam hulumtuar.

Më 9 mars 1973, Kryeministri Mehmet Shehu i dërgoi një letër të shkurtër Enver Hoxhës për ta njoftuar mbi përmbajtjen që do të kishte letra që do t'i dërgonte Çu En Lait lidhur me kërkesën për kredi të re për pesëvjeçarin e pestë.¹¹⁶ Sipas Mehmet Shehut në raportin dërguar Enver Hoxhës, Kinës do t'i kërkoheshin 8 vepra të plota, 36 vepra që projektoheshin nga shqiptarët dhe nga Kina do të kërkoheshin vetëm pajisjet, 21 vepra të tjera të reja dhe 25 zgjerime veprash ekzistuese.¹¹⁷

Si shumica e letrave që Mehmet Shehu i kishte dërguar homologut të tij kinez, edhe kjo letër është e mbushur plot e përplot me ideologji dhe justifikime. Sipas Shehut, plani i pestë pesëvjeçar do të synonte të zhvillonte më intensivisht industrinë e rëndë, sidomos në sektorin e naftës dhe gazit, minierave dhe ndërtimin e mëtejshëm të degëve të industrisë.¹¹⁸ Bujqësia edhe këtë herë do të kishte investime jo thelbësore.

¹⁰⁸ *Po aty*.

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ *Po aty*.

¹¹¹ *Po aty*.

¹¹² *Po aty*,

¹¹³ *Po aty*.

¹¹⁴ *Po aty*.

¹¹⁵ *Po aty*, fl. 3-7.

¹¹⁶ AQSH, F. 490/KM, V. 1970, D. 493, fl. 1. Kërkesë Republikës Popullore të Kinës për kredi të re për pesëvjeçarin e pestë 1971-1975.

¹¹⁷ *Po aty*, fl. 9.

¹¹⁸ *Po aty*, fl. 4.

Problem ende për Shqipërinë sipas Kryeministrit Shehu ishte ende plotësimi i nevojave të bukës në vend.¹¹⁹ Sipas Mehmet Shehut, Shqipëria ishte e gatshme t'i bënte Kinës një shlyerje prej 176 milion yuan që rridhnin nga kreditë e marra nga RPK.¹²⁰ Problemi kryesor që kishte Shqipëria në kushtet e likuiditetit financiar, ishte mungesa në valutë të huaj dhe pjesët e importit që nevojiteshin mund të mbuloheshin vetëm pjesërisht nga qeveria shqiptare.¹²¹ Për këtë arsye, qeveria e RPSH-së me porosi të Komiteti Qendror i kërkonte Kinës një kredi të re për periudhën 1971-1975 për ndërtimin e veprave të plota dhe kjo kredi mundësisht të shlyhej pas vitit 1990.¹²² Se sa do të ishte shuma e kredisë që kërkonte qeveria shqiptare, Mehmet Shehu në letrën e tij nuk jep asnjë shifër. Mesa duket, Shqipëria ia “kishte marrë dorën” kredive me Kinën. Nuk vendoste më shifra, thjesht priste sa do t'i akordonte vendi gjigant aziatik.

Kombinati metalurgjik ishte vepra që do të gllabëronte pjesën më të madhe të kredisë akorduar nga Kina. Më 4 shtator 1970, Mehmet Shehu i dërgoi një letër informuese Enver Hoxhës se nga bisedimet që po zhvilloheshin në Pekin pala shqiptare kishte kërkuar që projektin teknologjik të kombinatit, ta kalonte nga skema elektrometalurgjike, në skemën hidrometalurgjike.¹²³ Kjo do të thoshte se ky kombinat do të funksiononte jo me furra elektrike, por me furnalta.¹²⁴ Kjo ide kishte ardhur nga konsultimi ndërmjet Abdyl Këllezit dhe Adil Çarçanit në Pekin.¹²⁵ Kryeministri Shehu, sugjeronte që kjo vepër të mos e kalonte afatin e caktuar me marrëveshjen e vitit 1968, pra jo të përfundonte brenda vitit 1976, por në vitin 1975.¹²⁶ Lidhur me këtë çështje, Shehu kërkonte mendimin e Enver Hoxhës.¹²⁷ Hoxha, duke patur informacionin

¹¹⁹ *Po aty*, fl. 5.

¹²⁰ *Po aty*.

¹²¹ *Po aty*.

¹²² *Po aty*, fl. 6.

¹²³ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1970, D. 494, fl. 1. Letërkëmbim Hoxha-Shehu për kombinatin metalurgjik në Elbasan.

¹²⁴ *Po aty*.

¹²⁵ *Po aty*, fl. 6. Letër e Abdyl Këllezit dërguar Adil Çarçanit në Pekin, më 28 gusht 1970. Abdyl Këllezit nga ana e tij udhëzoi kryetarin e delegacionit Adil Çarçani që gjatë bisedimeve të këmbëngulte që metalurgjiku të funksiononte me furnaltë, të ulej energjia elektrike e tij, të shtohet koksi etj.

¹²⁶ *Po aty*.

¹²⁷ *Po aty*, fl. 2.

e letrës së Abdyl Këllezit për Adil Çarçanin që e konsideronte gjendjen në Kinë të mrekullueshme¹²⁸, e aprovoi menjëherë këtë ide. Ndërsa, përsa i përkiste problemit të pasurimit të fosforiteve dhe prodhimit të superfosfatit, kinezët ndaj kësaj kërkesë të Shqipërisë kishin rënë dakord që të dërgonin në Shqipëri një grup specialistësh për zgjidhjen e problemit të pasurimit të mineralit fosfatik.¹²⁹

Në letrën aprovuese që Enver Hoxha i dërgoi Mehmet Shehut për të gjitha këto probleme më 4 shtator 1970, por i thotë që ndërtimi i veprave ishte një problem i madh pasi Shqipëria për ndërtimin e tyre nuk mund të mbështetej tek Kuba apo Çekosllovakia për lëndë të parë sepse këto dy vende nuk e përpunonin mineralin hekurmbajtës, kështu që përpunimi hidrometalurgjik i tij do të mund të plotësohej vetëm nga teknologjia kineze.¹³⁰

Mehmet Shehu pas akordimit të kredisë nga ana e RPK-së, me një letër të datës 2 nëntor 1970, falënderoi ngrohtësisht Çu En Lain për ndihmën e re të akorduar nga Republika Popullore e Kinës.¹³¹ Nga ana e tij, Kryeministri kinez Çu En Lai me anë të një letre të datës 19 nëntor 1970 dërguar homologut të tij shqiptar, i shprehte se ndihej i lumtur për ndjenjat e miqësisë dhe të vëllazërisë së popullit shqiptar ndaj popullit

¹²⁸ *Po aty*, fl. 7. Pjesë nga letra e Abdyl Këllezit: "Gjendja në Kinë paraqitet e mrekullueshme. Duket kudo në çdo sektor konsolidimi i fitoreve të revolucionit, ka një ngritje të shpejtë të prodhimit dhe larmi të asortimenteve që po rriten. Bujqësia është shumë mirë, si asnjëherë. Na kanë bërë përshtypje të mëdha, ky hov revolucionar që ka shpërthyer kudo. Prodhohen pajisje të vështira elektronike në vende që nuk ta merr mendja, nëpër lagjet e Pekinit. Vrull i madh ka përfshirë provincat për t'u bërë të pavarura, industrinë e naftës, kimisë, mekanikës e të tjera degë. Tregu është plot me ushqime, mallra konsumi, pajisje për komunat si elektromotor, pajisje e instrumente të ndryshme. Kudo ngrihen ndërmarje e linja të reja".

¹²⁹ *Po aty*, fl. 19.

¹³⁰ *Po aty*, fl. 21.

¹³¹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1970, D. 493, fl. 35. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait: "Në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe të Këshillit të Ministrave e të gjithë popullit shqiptar, më lejoni që t'ju shpreh falënderimet dhe mirënjohjen time të singërtë Komitetit Qendror të Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës dhe personalisht udhëheqësit të madh Kryetarit Mao Ce Dun, si dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore që iu bë delegacionit tonë ekonomik qeveritar në Kinën e madhe Popullore dhe për ndihmën e re internacionaliste që iu dha popullit shqiptar nga ana e Republikës Popullore të Kinës dhe që u konkretizua me marrëveshjet e nënshkruara nga të dy Palët në Pekin më 16 tetor 1970"; shih edhe Gjon Boriçi, "Ndihmat dhe kreditë kineze për Shqipërinë, 1956-1975", në *Studime historike*, nr. 3-4/2018, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019, f. 199-216.

kinez dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe se miqësia kino-shqiptare ishte e pathyeshme dhe revolucionare.¹³²

Shqipëria e paspecializuar për të ndërtuar veprat e mëdha industriale

Për vënien në punë me efikasitet të veprave që do të ndërtoheshin nga kredia e madhe kineze kërkohej një nivel i lartë specializimi. Për këtë arsye, më datë 7 qershor 1971, Spiro Koleka, i dërgoi një letër informuese Hysni Kapos mbi nevojat dhe domosdoshmëritë që kishte Shqipëria për të dërguar njerëz në Kinë për specializim.¹³³ Sipas përlllogaritjeve që kishte bërë Spiro Koleka, Shqipëria për të gjitha veprat që ndërtonte me ndihmën e Kinës kishte nevojë të dërgonte për specializim në Kinë afërsisht 800 praktikantë.¹³⁴ Numri i praktikantëve shqiptarë që do të dërgoheshin fillimisht për specializim në Republikën Popullore të Kinës do të ishte si më poshtë:

1. Për Kombinatin Metalurgjik (faza I)	235 vetë
2. Për Uzinën e përpunimit të thellë të naftës	120 vetë
3. Për Fabrikën e PVC-së dhe sodës kaustike	48 vetë
4. Për fabrikën e pllakave prej fibre	3 vetë
5. Për TEC-in pranë Uzinës së naftës	-
6. Për zgjerimin e uzinës "Traktori"	35 vetë
7. Për uzinën e plehrave azotike Fier	18 vetë
8. Për zgjerimin e fabrikës së çimentos Fushë Krujë	-
9. Për zgjerimin e fabrikës së eternitit në Vlorë	-
10. Për fabrikën e prodhimeve prej plastmasi	5 vetë

¹³² *Po aty*, fl. 40, 41. Letër e Çu En Lait dërguar Mehmet Shehut.

¹³³ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1971, D. 487, fl. 1-2. Letër e Spiro Kolekës drejtuar Hysni Kapos.

¹³⁴ *Po aty*. Pjesë nga letra e Spiro Kolekës drejtuar Hysni Kapos: "Tani organet shtetërore kanë filluar nga zgjedhja e njerëzve në mënyrë që këta të jenë punonjës me përbërje të mirë politike e morale, të aftë nga ana shëndetësore dhe me arsimin përkatës. Është menduar që praktikantët, para se të dërgohen në Kinë, të futen në kurse disa mujore për t'i njohur në vija të përgjithshme me karakteristikat e veprës për të cilën do të përgatiten, t'u zhvillohen disa tema edukimi mbi qëndrimin korrekt në Republikën Popullore të Kinës dhe të mësojnë disa fjalë të gjuhës kineze. Qëllimi i këtyre masave paraprake është që këta të mund të mësojnë e të përfitojnë sa më shumë nga ana tekniko-profesionale gjatë qëndrimit në Kinë dhe të përgatiten sa më shpejt".

11. Për Kombinatin poligrafik	32 vetë
12. Për minierën dhe fabrikën e pasurimit të qymyrgurit Valias	- ¹³⁵

Problemet që po karakterizonin marrëdhëniet shqiptaro-kineze në gjysmën e parë të viteve 70-të, do të kishin impakt në të gjitha sferat ku Kina kishte investuar në Shqipëri. Njëlloj siç kishte ndodhur edhe me fillimet e problemeve me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik, njerëz të të gjitha kategorive që ishin të përfshirë në marrëdhëniet e vendit me Kinën filluan të bëhen objekt goditjesh nëpërmjet letrash dhe akuzazh. Në një letër dërguar Mehmet Shehut më datë 7 shkurt 1972, akuzohet një zyrtar i lartë i portit të Durrësit i quajtur Halil Vastjari se nuk kishte kryer detyrën gjatë tre vjetëve që ishte përgjegjës për shkarkimin e mallrave kineze dhe qëndrimit të tij në Kinë.¹³⁶ Kjo sipas letërshkruesve, kishte shkaktuar dëm në punë dhe përgjegjësi kishte shfaqur koncepte të huaja si indiferentizëm, dembelizëm dhe mendjemadhësi.¹³⁷ Por, fati i përgjegjësit Halil Vastjari nuk ishte i keq sepse pasi u morën të dhënat përkatëse për punën e tij kishin folur shumë mirë edhe drejtori i shoqërisë së lundrimit shqiptaro-kineze Qemal Klosi edhe punonjësit e ambasadës shqiptare në Pekin.¹³⁸ Megjithatë, edhe pse "ia hodhi paq", Halil Vastjari vetëm nga letra dërguar Mehmet Shehut nuk do të shkelte më në Kinë, madje iu hoq edhe propozimi për ta emëruar drejtor në parkun e delegacioneve.¹³⁹

Për të treguar se marrëdhëniet me Kinën nuk kishin pësuar ndryshime, më 30 gusht 1973, zëvendëskryeministri Adil Çarçani priti në zyrë një grup turistësh kinezë.¹⁴⁰ Në fjalën e tij Çarçani u përpoq të jepte përshtypjen se shkëmbimi i turistëve kinezë dhe shqiptarë në vendet respektive do t'i shërbente më shumë rritjes së miqësisë së madhe

¹³⁵ *Po aty*, fl. 3. "Shënim: Për veprat e tjera, numri i praktikantëve shqiptarë që do të dërgohen për specializim në Republikën Popullore të Kinës do të caktohet kur të aprovohen PDZ-të ose kur të bëhet lidhja e kontratave".

¹³⁶ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1972, D. 526, fl. 1. Letër mbi dobësitë në punë të shoqërisë së lundrimit shqiptaro-kineze.

¹³⁷ *Po aty*.

¹³⁸ *Po aty*, fl. 3. Pjesë nga letra e Milo Qirkos dërguar Adil Çarçanit, më 21 prill 1972, pas verifikimeve të kryera për punën e Halil Vastjarit.

¹³⁹ *Po aty*, fl. 6.

¹⁴⁰ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1973, D. 657, fl. 1. Takim i zëvendëskryeministrit të Republikës Popullore të Shqipërisë me një grup turistësh kinezë.

ndërmjet dy vendeve.¹⁴¹ Ky fakt sipas Çarçanit, do t'i shërbente ndërtimit të socializmit.¹⁴² Shkëmbimet e eksperiencave shqiptaro-kineze si dhe këmbimet e mallrave, ishin në qendër të bisedimeve. Një nga anëtarët e delegacionit kinez i tha Adil Çarçanit se në Kinë ishin asfaltuar rrugë automobilistike me bitumin shqiptar.¹⁴³ Nga ana e tij, zëvendëskryeministri shqiptar iu shpreh delegacionit kinez se me ndihmën e specialistëve të tyre, shqiptarët ishin duke përmirësuar teknikën e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës.¹⁴⁴ Synimi i kësaj bisede që po zhvillonte Adil Çarçani ishte që nga Kina të fillonte të vinte në Shqipëri teknologjia për shpimin e puseve të naftës dhe të gazit në detin Adriatik dhe këtë fakt zëvendëskryeministri nuk ia fshehu ambasadorit kinez të pranishëm në takim.¹⁴⁵ Nga ana e tij, ambasadori kinez Liu Xhen Hua, nuk i përgjigjet për këtë çështje, por e ktheu bisedën tek eksperimentet që po kryeheshin në Kinë për të përfunduar ndërtimin e plotë dhe me sukses të Kombinatit Metalurgjik në Elbasan.¹⁴⁶ Lidhur me këtë vepër, një nga anëtarët e delegacionit kinez i shprehet Adil Çarçanit se nga përmasat një kombinat i tillë ende nuk ishte ndërtuar në Kinë.¹⁴⁷ Për të mos mbetur pa fjalë, Adil Çarçani me shumë takt e ktheu bisedën tek sukseset që kishte korrur Kina dhe mbi të gjitha tek pranimi i saj në OKB, por pa përmendur rezolutën shqiptare të pranimit të saj.¹⁴⁸ Nga ana e tij edhe ambasadori kinez nuk mund të rrinte pa thënë fjalë të mira për miqësinë ndërmjet dy

¹⁴¹ *Po aty*.

¹⁴² *Po aty*.

¹⁴³ *Po aty*, fl. 3.

¹⁴⁴ *Po aty*, fl. 4.

¹⁴⁵ *Po aty*.

¹⁴⁶ *Po aty*.

¹⁴⁷ *Po aty*, fl. 5.

¹⁴⁸ *Po aty*, fl. 8. Pjesë nga fjala e Adil Çarçanit: "Ne na gëzojnë shumë dhe pa masë sukseset që ka arritur Republika Popullore e Kinës në të gjitha drejtimit në drejtim të luftës ideologjike, për mposhtjen e ideologjisë së huaj, borgjeze, mikroborgjeze dhe revizioniste, për krijimin e njeriut të ri, etj. Po ashtu sukseset e mëdha që kini arritur në shkencë e në teknikë, deri në majat më të larta të saj. Ne gëzohemi shumë për sukseset e Kinës Popullore në arenën ndërkombëtare. Pranimi i Kinës në OKB ishte një sukses dhe frymëzim i madh për popullin kinez dhe për të gjithë popullin tonë. Ne gëzohemi shumë që Kina çdo ditë po i shton lidhjet dhe marrëdhëniet ekonomike dhe diplomatike me popujt dhe vendet e ndryshme. Tani, në Kinë po zhvillohen bisedimet me Japoninë, ne kemi besim se këto bisedime do të përfundojnë me sukses. Këto do të jenë një rritje e mëtejshme e prestigjit të Republikës Popullore të Kinës".

vendeve që sipas tij ishte farkëtuar nga dy udhëheqësit e mëdhenj, Mao Ce Dun dhe Enver Hoxha.¹⁴⁹

Përfundime

Ndërtimi i veprave të mëdha industriale me ndihmat dhe kreditë kineze në harkun kohor 1969-1973, ishin jashtë çdo dyshimi një ndihmë e madhe për Shqipërinë. Megjithatë, edhe këtë herë, keq menaxhimi i kredive kineze do të sillte stanjacion ekonomik për Shqipërinë. Investimi i pjesës dërrmuese të kredive kineze në industrinë e rëndë, do të ndihej shumë në nivelin e jetesës së popullit shqiptar. Një tjetër mangësi që kishte Shqipëria në procesin e industrializimit të saj, ishte edhe mungesa totale e eksperiencës në këtë fushë. Procesi i industrializimit të vendit kishte filluar që me marrëdhëniet e ngushta me Bashkimin Sovjetik, por pa rezultate të frytshme. Madje, nga udhëheqja komuniste e kohës, Bashkimi Sovjetik do të akuzohej si dëmtuesi më i madh i ekonomisë së Shqipërisë, kur në fakt gjatë gjithë viteve 50-të kishin qenë ndihmat dhe kreditë sovjetike ato që kishin bërë të mundur mbajtjen në këmbë të ekonomisë shqiptare. E njëjta gjë do të ndodhte edhe me Republikën Popullore të Kinës. Shqipëria nëpërmjet udhëheqjes së saj kërkonte të shkonte përtej mundësive reale që kishte për t'u industrializuar. Në të gjithë historinë njerëzore, procesi i industrializimit, është një proces kompleks që është realizuar vetëm atëherë kur popujt e shteteve të caktuar arritën pjekurinë e duhur shoqërore për një kapërcim të tillë cilësor. Siç e pamë, edhe në këtë artikull, industrializimi kërkonte shpenzime të mëdha financiare dhe njerëz të specializuar më së miri për të vënë në punë veprat industriale. Do të ishte e pamundur për Shqipërinë që vetëm pas tridhjetë vjetësh nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore të mund të arrinte “me një të kërcitur të gishtave” nivelin industrial të vendeve të tjera, kur ishte fare mirë e ditur se ishte vendi pa asnjë lloj

¹⁴⁹ *Po aty*, fl. 11. Pjesë nga fjala e ambasadorit kinez Liu Xhen Hua: "Kjo miqësi është farkëtuar nga personalisht dy udhëheqësit tanë të mëdhenj, të Kinës dhe të Shqipërisë, nga shoku Enver dhe nga Kryetari Mao Ce Dun. Prandaj, siç thatë edhe ju, kjo miqësi është e përjetshme dhe e pathyeshme, sepse është ndërtuar mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar...Ne kemi parë nga afër se kudo në Shqipëri, shokët shqiptarë mbajnë në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, si në bregdet dhe në kufi të gjithë ushtarët dhe gjithë masa e popullit shqiptar mbajnë fort në duart e tyre pushkën".

eksperience në këtë fushë. Nuk ishte e rastësishme që për çdo dështim apo keqfunksionim të pajisjeve industriale, qeveria shqiptare ia hidhte gjithnjë fajin të tjerëve. Njëlloj si në rastin e marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Sovjetik, edhe marrëdhëniet me Republikën Popullore të Kinës do të pësonin të njëjtin fat, dhe gjithmonë fajtorë do të ishin të tjerët, asnjëherë shqiptarët.

S u m m a r y

THE EFFORTS OF THE ALBANIAN GOVERNMENT TO ACHIEVE THE COUNTRY'S INDUSTRIALIZATION THROUGH THE LAST MAJOR WORKS BY CHINA IN ALBANIA, 1966-1973

The construction of big industrial works with the Chinese aids and loans during the space time 1969-1973, were beyond any doubt a big help for Albania. Nevertheless, once more, the bad management of the Chinese loans would bring economic stagnation for Albania. The investment of the overwhelming part of the Chinese loans on heavy industry, would be seriously felt at the life level of the Albanian people. Another shortcoming that Albania had in the process of its industrialization, was the total lack of experience in this field. The process of the country's industrialization had started since the close relations with the Soviet Union, but with fruitless outcome. Also from the time's communist leadership of Albania, the Soviet Union would be accused as the greatest detrimental element of the Albanian economy, when in fact during all the '50ies, had been the Soviet aids and loans that have made possible the support of the Albanian economy. The same thing would happen with the People's Republic of China. Albania through its leadership wanted to go beyond her real possibilities to be industrialized. In all the human history, the industrialization process is a very complex one that has been accomplished only when the people of specific countries have achieved the right social maturity for such a qualitative leap. As we also saw in this paper, the industrialization required big amounts of money and specialized people to the best to put at work the industrial works. Would have been impossible for Albania that only after thirty years of the Second World War's end to achieve by a finger clap the industrial level of other countries, when was very well known that the country was without any kind of experience in this field. Was not casual that for every

failure or malfunction of the industrial equipments, the Albanian government always blamed the others. The same as in the case of the economic relations with the Soviet Union, also the relations with the People's Republic of China would occur the same destiny, and always the guilty were the others, never the Albanians.